



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Adresa: Bulevardi "Zog I", Godina 57/2, Nr.18 Tiranë,

Tel/Fax: 04 2268141; 2268142

Nr. 960/14 Prot.

Tiranë, më 22.07.2016

**V E N D I M**

Nr. 87, Datë 22/07/2016

**Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes, në lidhje me zbatimin e ligjit në procesin e administrimit të shërbimit civil, në Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, neneve 80-104 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", dispozita të cilat në mbështetje të nenit 185 të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", lejohet të veprojnë, si dhe të Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me mbikëqyrjen e zhvilluar në institucionin, Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit,

**VËREJ SE:**

Me vendimin nr. 139, datë 30.12.2015 "Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në procesin e administrimit të shërbimit civil në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe institucionet e varësisë që janë pjesë e shërbimit civil", është urdhëruar të fillojë mbikëqyrja e përgjithshme, në lidhje me administrimin e shërbimit civil në institucionin, Ministria e Punëve të Brendshme dhe institucionet e varësisë që janë pjesë e shërbimit civil.

Objekti i mbikëqyrjes në këtë institucion është i përgjithshëm dhe ka përfshirë monitorimin, kontrollin dhe vlerësimin e zbatimit të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar dhe akteve nënligjore, për të gjithë institutet e tij.

Administrimi i të dhënave dhe grumbullimi i dokumentacionit në subjekt filloi në datën 21.04.2016, sipas programit të mbikëqyrjes të miratuar nga Komisioneri, nr. 960/1 prot., datë

30.12.2015, njoftuar institucionit me shkresën nr. 960/2 prot., datë 30.12.2015 “Njoftim për fillimin e mbikëqyrjes”.

Në përfundim të procesit të verifikimit të dokumentacionit dhe grumbullimit të të dhënave, grupi i mbikëqyrjes ka hartuar projektraportin për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, dërguar për njohje subjektit të mbikëqyrur me shkresën nr. 960/5 prot., datë 20.06.2016 të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, “Dërgohet projektraporti në përfundim të mbikëqyrjes në Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit, në lidhje me administrimin e shërbimit civil”, duke i lënë 10 ditë kohë për të paraqitur komentet e tyre në lidhje me konstatimet e evidentuara nga grupi i mbikëqyrjes.

Me shkresën nr. 960/6 prot., datë 20.06.2016 të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, “Dërgohet projektraporti në përfundim të mbikëqyrjes në Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit, në lidhje me administrimin e shërbimit civil”, projektraporti i mbikëqyrjes i është dërguar për njohje Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme, që është ministria nga e cilat varet institucioni i mbikëqyrur.

Me shkresën nr. 960/7 prot., datë 20.06.2016 të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, “Dërgohet projektraporti në përfundim të mbikëqyrjes në Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit, në lidhje me administrimin e shërbimit civil”, projektraporti i mbikëqyrjes i është dërguar për njohje edhe Departamentit të Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse në këtë rast.

Subjekti i mbikëqyrur pasi është njohur me projektraportin dhe gjetjet e grupit të punës, me shkresën nr. 453/7 prot., datë 01.07.2016, “Observacion mbi projektraportin për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në DPRMSH”, ka dërguar projektraportin e nënshkruar së bashku me observacionet përkatëse. Bashkëlidhur me observacionet janë dërguar edhe sqarimet e një punonjësi, për të cilin është analizuar marrëdhënia e punësimit në projektraport.

Sqarimet e dërguara nga subjekti i mbikëqyrur së bashku me materialet përkatëse provuese, janë administruar në dosjen e mbikëqyrjes.

Nga ana e Komisionerit u analizua përmbajtja e observacioneve, si dhe e akteve që i shoqërojnë ato, u krahasuan me gjetjet e grupit të mbikëqyrjes, të evidentuara në projektraport dhe qëndrimi në lidhje me to, është materializuar në pjesët përkatëse të raportit.

Në përmbajtjen e observacioneve të paraqitura nga institucioni pretendohet se është reaguar në lidhje me disa parregullsi të evidentuara gjatë procesit të mbikëqyrjes, të cilat kanë të bëjnë me institutet e përshkrimit të punës, periudhën e provës dhe plotësimin e kërkesave për të qenë pjesë e shërbimit civil.

Por, nisur nga aktet administrative bashkëlidhur observacioneve, konstatohet se situata është përmirësuar vetëm për një pjesë të konstatimeve dhe në këto kushte, verifikimi i përmbushjes së këtyre detyrave, në zbatim të rekomandimeve të Komisionerit, do të jetë objekt i verifikimit të mëtejshëm, në vijim të procesit të mbikëqyrjes në këtë institucion, pas miratimit të raportit përfundimtar.

Sa më sipër, çmoj se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij në lidhje me problematikën e evidentuar.

Në këto rrethana, pasi shqyrtova raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, të paraqitur për miratim nga grupi i punës, vlerësoj se duhet të miratoj përmbajtjen e tij.

### **Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe Rregulloren “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

### **V E N D O S A:**

1. Të miratoj raportin përfundimtar të mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me administrimin e shërbimit civil në Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit, i cili do të jetë pjesë e këtij vendimi.
2. Institucioni i mbikëqyrur t’i kërkojë njësisë përgjegjëse, (DAP), që të japë mendimin lidhur me përshkrimet e punës nëse janë të hartuara në përputhje me legjislacionin specifik të fushës apo formatin standard të miratuar.
3. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme, pas marrjes së konfirmimit nga njësia përgjegjëse, të vijojë procesin duke nënshkruar përshkrimet e punës në ndarjen përkatëse, siç parashikohet në pikën 18, shkronja “c”, të vendimit nr. 142, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar.

Një kopje e përshkrimeve të punës të nënshkruara të bëhen pjesë e dosjes së personelit të çdo nëpunësi civil, një kopje të depozitohet në arkivin e institucionit dhe një kopje të depozitohet pranë Departamentit të Administratës Publike.

4. Nëpunësit civilë në periudhë prove, të vendosen nën kujdesin e nëpunësit më të vjetër civil. Në përfundim të periudhës së provës, mendimi me shkrim i nëpunësit më të vjetër duhet të bëhet pjesë e procedurës së konfirmimit të nëpunësit civil.
5. Njësia e burimeve njerëzore e institucionit të mbikëqyrur, të nxjerrë vendimin për deklarimin e shuarjes së masës disiplinore “Vërejtje”, të marrë për nëpunësit \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\*.

Masa disiplinore “Vërejtje”, të fshihet nga dosja e personelit dhe regjistri përkatës.

6. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **60** ditë nga marrja dijani për këtë vendim. Institucioni i mbikëqyrur dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim duke u bazuar në rekomandimet e dhëna në përmbajtjen e raportit.

7. Me kalimin e këtij afati, subjekti i mbikëqyrur, Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit, duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
8. Për këtë vendim të njoftohet Drejtoria e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Departamenti i Administratës Publike, duke i dërguar një kopje të raportit përfundimtar të mbikëqyrjes dhe njëkohësisht, të informohet Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në Kuvendin e Shqipërisë.
9. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONERI**

**Pranvera STRAKOSHA**